



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
Ministry of Culture, Youth and Sports

Prishtinë, 17.06.2020

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në zbatim të objektivës: Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë

1. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit në përputhje me Strategjinë për Rini 2019-2023 dhe Planin e Veprimit për Rini 2019-2023 u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e mjedisit të shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në këtë objektivë.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre në kuadër të objektivës Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë në **fushat prioritare në vijim:**

Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rekreative

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në **avancimin dhe fuqizimin e sektorit të rinisë** përmes aktiviteteve si më poshtë:

- ✓ **Integrimi shoqëror i të rinjve përmes kulturës, sportit dhe rekreacionit**
- ✓ **Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve**
- ✓ **Mbështetja e femrave të reja dhe të rinjve në zonat rurale**
- ✓ **Përkrahja e të rinjve në iniciativa kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sportit dhe kulturës.**
- ✓ **Organizimi aktiviteteve tradicionale për të rinjtë.**

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **100.000,00** euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **1.000,00** euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **5.000,00** euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 08.07.2020

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e rinisë përkatësisht të komponentës se pjesëmarrjes. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesve të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqes prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.mkrs-ks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e më poshtme:

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ish-Ndërtesa e Partive Politike, Zyra e Arkivit, nr. 22,
Sheshi Nëna Terezë, Nr 35, 10000 Prishtinë

Procesi i pranimin, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: drton.rukiqi@rks-gov.net.